

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, koleji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa, kryetare, Nebojsha Boriçiq dhe Avdi Dinaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Minire Xhambazi, procesmbajtëse, në çështjen penale të dënuarit I. A., nga Prishtina, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 par. 5 lidhur me par. 3 dhe 1 të KPK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë , të paraqitur nga i dënuari, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, P.nr.354/2013 datë 21.3.2016, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, PA I.nr.718/2016 datë 2.9.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 12 dhjetor 2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pjesërisht aprovohet kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit I. A., anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë, PA I .nr.718/2016 datë 2.9.2016 dhe çështja i kthehet asaj gjykate në rivendosje.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, P.nr.354/2013 datë 21.3.2016 i dënuari I. A. është shpallur fajtor për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 297 par. 5 lidhur me par. 3 dhe 1 të KPK-së, dhe për këtë vepër penale i është shqiptuar dënimi i kushtëzuar me ç'rast i është përcaktuar dënimi me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari në afat prej 2 vitesh nuk kryen vepër të re penale, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 17.11.2012 gjer më 11.12.2012. Të dëmtuarit B. D., F. D., L. M. K., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, janë

udhëzuar në kontest civil. I dënuari është detyruar që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 90,88 € ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 30 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Ky aktgjykim është ndryshuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, PA I .nr.718/2016 datë 2.9.2016 në mënyrën sa vijon:

“I. Me aprovimin e ankesës së PTH në Gjakovë, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, P.nr.354/2013 datë 21.3.2016, ndryshohet sa i përket cilësimit juridik të veprës penale dhe vendimit mbi dënimin, ashtu që kjo gjykatë të akuzuarit I. A. për veprën penale, rrezikimi i trafikut publik, nga neni 297 par. 5 lidhur me par. 3 dhe 1 të KPK i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, të cilin dënim do ta vuajë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

II. Në pjesët tjera aktgjykimi ngelë i pandryshuar.”

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur i dënuari I. A., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së Ligjit penal, me propozim që aktgjykimi i shkallës së dytë të anulohet dhe çështja t'i kthehet të njëjtës gjykatë në rivendosje.

Përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur Prokurori i Shtetit të Kosovës me parashtrësën KMLP.II.nr.219/2016 datë 23.11.2016 me propozim që e njëjta të refuzohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes konform dispozitës së nenit 435 par. 1 dhe 436 par. 1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Aktgjykimi i shkallës së dytë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase nuk ka arsye për faktet vendimtare që kanë të bëjnë me vendimin për dënimin, ndërsa ato që janë dhënë janë të paqarta nga arsyet si në vijim:

Gjykata e Apelit me rastin e aprovimit të ankesës së Prokurorit të Shtetit dhe ndryshimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë thekson:” se i akuzuari nuk i përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe gjendjes së rrugës por edhe që bënë tejkalimin e shpejtësisë së lëvizjes nga 50 km/h e lejuar në 65 km/h, si përgjegjës primar për aksidentin e shkaktuar andaj kjo Gjykatë vlerëson se përgjegjësia penale e të akuzuarit është e lartë...”

Këto arsye janë të paqarta për faktin se në rastin konkret nuk mund të merren si rrethana rënduese elementet qenësore të veprës penale për faktin se vet ligdhënësi i ka dhënë karakterin rëndues ngase mos të ishte rezultat i shkeljes së rregullave në trafik, nuk do të bëhej fjalë për këtë vepër penale, edhe nga vet diapozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë shihet tejkalimi i shpejtësisë së lëvizjes nga 50km/h që është e lejuar në 65km/h, se edhe gjykata e shkallës së parë i ka konstatuar lëshimet primare të të dënuarit e nga ana tjetër elementet qenësore të veprës penale për të cilat i dënuari është shpallur fajtor, nuk mund të paraqesin njëkohësisht edhe rrethana rënduese. Për me teper, vet ligdhënësi ka përcaktuar në mënyrë taksative rrethanat determinuese që gjykata mund t'i marrë parasysh me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Po ashtu, duhet theksuar se dënimi i shqiptuar nuk është në koherencë me shkallën e rrezikshmërisë që paraqesin vepra të tilla që ligjvënësi u ka vënë këtyre veprave penale duke e paraparë minimumin dhe maksimumin e dënimeve, mirëpo, gjykata e shkallës së dytë, duhet të jep arsye të qarta kur e ndryshon aktgjykimin e ankimuar nga sa u tha më lartë, se në rastin konkret arsyet e dhëna nuk janë të qarta, andaj këto mangësi kushtëzuan anulimin e aktgjykimit të shkallës së dytë.

Duke pasur parasysh këtë gjendje të çështjes, kjo Gjykatë vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë kushtëzuar anulimin e tij andaj konform dispozitës së nenit 438 par. 1 pika 1.2. të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

PML.nr.293/2016 datë 14 dhjetor 2016

Procesmbajtëse,
Minire Xhambazi

Kryetar i kolegjit,
Emine Mustafa